



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.15, datë 17. 07. 2009

**PËR
“MIRATIMIN E PROJEKTIT TË BASHKISË SË TIRANËS “STRATEGJIA PËR
ZHVILLIMIN E QYTETIT TË TIRANËS” DHE PËR PËRDORIMIN E FONDIT
REZERVË””**

Mbështetur në nenin 19, pika 9, nenin 10, pika 3/III, shkronja “a”, nenin 32, shkronja “dh” të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); nenin 6 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; nenin 6, shkronja “b” të ligjit nr.7776, datë 22.12.1993 për “Buxhetin lokal” (i ndryshuar) dhe në VKB-në nr.1, datë 03.02.2009 për “Miratimin në parim të programit buxhetor afatmesëm për vitet 2009-2011 dhe miratimin e detajimit të buxhetit të Bashkisë së Tiranës, për vitin 2009”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Të miratojë projektin “Strategjia për zhvillimin e qytetit të Tiranës”, me afat kohor 18 muaj, të bashkëfinancuar nga Cities Alliance - Banka Botërore, GTZ dhe Bashkia e Tiranës, në shumën totale prej 375,000 (treqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) USD, sipas “Tabela nr. 1”, bashkëlidhur si pjesë përbërëse e vendimit.
2. Efektet financiare të Bashkisë së Tiranës për vitin 2009 në shumën prej 800,000 (tetëqind mijë) Lekë, do të shtojnë buxhetin e Njesisë së Menaxhimit të Projekteve në artikullin 602 (shpenzime operative sipas specifikimeve të vendosura në projekt), duke pakësuar në po këtë shumë fondin rezervë të miratuar në buxhetin e Bashkisë së Tiranës për vitin 2009.
3. Efektet financiare të Bashkisë së Tiranës për periudhën në vazhdim pas vitit 2009, do të jenë të ndara sipas fazave të projektit të shprehura në “Tabela nr. 2”, do të shtojnë buxhetin e Njesisë së Menaxhimit të Projekteve në artikullin 602 (shpenzime operative sipas specifikimeve të vendosura në projekt).
4. Njësia e Menaxhimit të Projekteve në mbështetje të legjislacionit aktual financiar do të jetë struktura përgjegjëse për zbatimin e projektit.

5. Për monitorimin e zbatimit të vendimit ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Planifikimit, Drejtoria e Përgjithëshme e Kontrollit të Zhvillimit Urbanistik e Teritorrit, Drejtoria e Përgjithëshme e Manaxhimit të Shërbimeve.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

Sokol DERVISHAJ

K R Y E T A R

Tabela nr. 1 - Buxheti Total i Projektit “Strategjia për zhvillimin e qytetit të Tiranës”

Buxheti total i projektit (US\$)	375,000
Granti i dhënë nga City Alliance	250,000
Kontributi i GTZ	75.000
Kontributi i Bashkisë së Tiranës	50,000

Tabela nr. 2 - Zbërthimi i shumës së financuar nga Bashkia e Tiranës për projektin “Strategjia për zhvillimin e qytetit të Tiranës”

Komponentët / Aktivitetet Kryesore	Totali	Lloji i Shpenzimeve			
		Ditë pune të administratës për projektin (US\$)	Ngritje Kapacitetesh (US\$)	Botime, fotokopje, etj. (US\$)	Të tjera (US\$)
Ativitetet e Projektit:					
Faza	6,335				
Faza 2	15,040				
Faza 3	28,625				
<i>Total i Projektit (USD)</i>	50,000	7,000 (in kind)	18,000	15,000	10,000
<i>Total i Projektit (Lekë)</i>	5,000,000	700,000	1,800,000	1,500,000	1,000,000